

SHQIPËRIA dhe KOSOVA PËRTEJ BRISHTËSISË

Një rrugëtim për rritje të qëndrueshme i Shqipërisë dhe Kosovës
përtej 2025

Shqipëria dhe Kosova përtej brishtësisë

Një rrugëtim për rritje të qëndrueshme i Shqipërisë dhe Kosovës përtej 2025



ALTAX – QENDRA SHQIPTARE PËR POLITIKA EKONOMIKE DHE FISKALE

Platforma për Transparencë, Financë Publike dhe Politika Fiskale

 www.altax.al |  info@altax.al

Dokument Politikash | Nr. 2025/11/24

Shqipëria dhe Kosova përtej brishtësisë

Një rrugëtim për rritje të qëndrueshme i Shqipërisë dhe Kosovës përtej 2025

Përgatitur dhe publikuar nga ALTAX

 **Nëntor 2025**

ALTAX - ALBANIAN CENTER FOR ECONOMIC AND FISCAL POLICY STUDIES

Platform for Transparency, Public Finance and Fiscal Policy

 www.altax.al |  info@altax.al

Working Paper | No. 2025/11/24

Albania and Kosovo beyond fragility

A sustainable growth path for Albania and Kosovo beyond 2025

Prepared and published by ALTAX

 **November 2025**

ALTAX — Qendra Shqiptare për Politika Ekonomike dhe Fiskale

Një qendër kërkimore dhe zhvillimore për një të ardhme më transparente dhe të qëndrueshme ekonomike

Rreth ALTAX

ALTAX është një organizatë jofitimprurëse me bazë në Shqipëri, që funksionon si qendër studimore e pavarur për politika ekonomike dhe fiskale. Misioni i saj është të ofrojë analizë të thelluar, të paanshme dhe të besueshme mbi zhvillimet ekonomike dhe fiskale në Shqipëri, duke vlerësuar ndikimet që burojnë nga faktorë politikë, kulturorë, ideologjikë, ekonomikë dhe historikë.

Synimi i ALTAX është të kontribuojë në formulimin e politikave efektive që shërbejnë jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin më të gjerë të Ballkanit Perëndimor.

Fokusi dhe Veprimtaria

ALTAX bashkëpunon me akademikë, ekspertë fiskalë dhe organizata ndërkombëtare, me qëllim rritjen e kapaciteteve analitike dhe të politikëbërjes në Shqipëri dhe Kosovë.

Përmes analizave të detajuara mbi ekonominë, sistemin tatimor dhe indikatorët makro/mikroekonomikë, ALTAX mbështet transparencën, llogaridhënien dhe përmirësimin e vendimarrjes publike.

Fushat e Angazhimit

- Studimi i tregjeve dhe tendencave sektoriale
- Analiza e buxhetit të shtetit dhe e të dhënave statistikore
- Hartimi i raporteve mbi politikat ekonomike dhe fiskale
- Parashikimi i zhvillimeve të ardhshme për donatorë dhe palë të interesuara
- Vlerësimi i ndikimit të politikave fiskale dhe monetare në shoqëri dhe ekonomi

Shërbimet e ALTAX

- Përgatitja e analizave mbi politikat ekonomike dhe fiskale
- Hartimi i modeleve të politikave publike dhe ekspertizave sektoriale
- Realizimi i studimeve dhe raporteve në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë
- Vlerësimi i trendeve të tregut dhe faktorëve ndikues
- Përpunimi i të dhënave për ndikim në formulimin e politikave

Kontakti

 Për më shumë informacion mbi analizat dhe shërbimet që ofron ALTAX, vizitoni platformën zyrtare ose kontaktoni direkt qendrën. Ekipi i ALTAX është i gatshëm të ofrojë zgjidhje të personalizuar për pyetje ose kërkesa specifike.

 www.altax.al |  info@altax.al

ALTAX — Albanian Center for Economic and Fiscal Policy

A research and development center for a more transparent and sustainable economic future

About ALTAX

ALTAX is a non-profit organization based in Albania, functioning as an independent research center for economic and fiscal policy. Its mission is to provide in-depth, unbiased, and reliable analysis on economic and fiscal developments in Albania, evaluating the impacts of political, cultural, ideological, economic, and historical factors.

ALTAX aims to contribute to the formulation of effective policies that serve not only Albania but also the wider Western Balkans region.

Focus and Activities

ALTAX collaborates with academics, fiscal experts, and international organizations to strengthen analytical and policymaking capacities in Albania and Kosovo.

Through detailed analyses of the economy, tax system, and macro/microeconomic indicators, ALTAX supports transparency, accountability, and improved public decision-making.

Areas of Engagement

- Market studies and sectoral trend analysis
- State budget and statistical data analysis
- Preparation of reports on economic and fiscal policies
- Forecasting future developments for donors and stakeholders
- Assessing the impact of fiscal and monetary policies on society and the economy

Services provided by ALTAX

- Preparation of analyses on economic and fiscal policies
- Development of public policy models and sectoral expertise
- Conducting studies and reports in collaboration with national and international partners
- Evaluation of market trends and influencing factors
- Data processing to inform policymaking

Contact



For more information on ALTAX analyses and services, visit the official platform or contact the center directly. The ALTAX team is ready to provide customized solutions for specific questions or requests.



www.altax.al |  info@altax.al

KUSHTET E PËRDORIMIT

Ky dokument është i mbrojtur me të drejta autori dhe ofrohet për përdorim jo-komercial, nën kushtet e mëposhtme të përcaktuara nga Qendra ALTAX:

1. Përdorim personal dhe profesional

Dokumenti mund të përdoret për qëllime studimore, kërkimore, profesionale dhe akademike. Çdo përdorim komercial pa autorizim të drejtpërdrejtë dhe të shkruar nga ALTAX është i ndaluar.

2. Detyrimi për citim të burimit

Në rast përdorimi për punime akademike, publikime kërkimore, dokumente zyrtare apo materiale të tjera analitike është i detyrueshëm citimi korrekt i burimit origjinal dhe autorëve përkatës.

3. Kufizime në përdorim

Ky material nuk mund të përdoret në forma që mund të shkaktojnë dëme ekonomike, reputacionale apo ligjore për individë apo institucione të tjera.

4. Opinione të autorëve

Të gjitha mendimet dhe përfundimet e shprehura janë ekskluzivisht të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrime zyrtare të Qendrës ALTAX. ALTAX nuk angazhohet në pozicionime politike institucionale, ndonëse analizat mund të përfshijnë vlerësime mbi politika publike.

5. Përgjegjësia e publikimit

Ky studim është botuar nën përgjegjësinë e ALTAX. Qëndrimet e paraqitura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e drejtimit apo partnerëve të Qendrës.

6. Riprodhimi dhe shpërndarja e përmbajtjes

Nëse teksti apo pjesë të tij shpërndahen, duhet të paraqiten në mënyrë të saktë dhe të plotë, duke i atribuar burimit origjinal autorësinë dhe përmbajtjen. Çdo përdorim i të dhënave dhe analizave duhet të shoqërohet me referencën përkatëse nga ky publikim.

7. Përgjegjësia e shpërndarësve të materialit

Përdoruesit që e shpërndajnë këtë dokument përmes çdo forme (fizike apo dixhitale) pranojnë të marrin masa të arsyeshme për të informuar përdoruesit përfundimtarë mbi këto kushte dhe të promovojnë zbatimin e tyre.

8. Ndalesa për shitje të paautorizuar

Çdo përpjekje për të shitur këtë dokument tërësisht ose pjesërisht, si produkt më vete apo i integruar, kërkon më parë një autorizim të shkruar nga Qendra ALTAX.

Fjalë kyçe: rritje ekonomike, stabilitet fiskal, integrim rajonal, fuqi punëtore, institucione të forta, digjitalizim, diversifikim sektorial, Shqiperi, Kosove, reforma strukturore

Kodi JEL: E02, E62, F15, J24, O11, O33, O47, R11

© Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij studimi mund të përdoret lirisht për qëllime jo-fitimprurëse, me kusht që të citohet qartë Qendra ALTAX si burim origjinal.

TERMS OF USE

This document is protected by copyright and made available for non-commercial use under the following conditions set by the ALTAX Center:

1. **Personal and professional use**

This document may be used for educational, research, professional, and academic purposes. Any commercial use without prior written authorization from ALTAX is strictly prohibited.

2. **Source attribution requirement**

When used in academic work, research papers, or other publications, the original source and relevant authors must be properly cited.

3. **Usage restrictions**

The material must not be used in ways that may cause economic, reputational, or legal harm to individuals or institutions.

4. **Authorial opinions**

The views and conclusions expressed herein are solely those of the authors and do not represent institutional positions of the ALTAX Center. While the analyses may address public policies, ALTAX maintains neutrality and does not take official political stances.

5. **Publication responsibility**

This study has been published under the responsibility of ALTAX. The content does not necessarily reflect the views of its leadership or partners.

6. **Content reproduction and sharing**

If the content (text or any part) is shared or reproduced, it must be presented faithfully and attributed to the original source. Any use of data or analysis must include a proper reference to this publication.

7. **Distributor responsibility**

Users who distribute this document in any form (physical or digital) agree to take reasonable steps to inform end-users of these terms and promote compliance.

8. **Prohibition of unauthorized sale**

Any attempt to sell this content in whole or in part, whether as a standalone product or bundled, requires prior written approval from the ALTAX Center.

Keywords: economic growth, fiscal stability, regional integration, workforce, strong institutions, digitalization, sectoral diversification, Albania, Kosovo, structural reforms

JEL Code: E02, E62, F15, J24, O11, O33, O47, R11

© All rights reserved.

The content of this study may be used freely for non-commercial purposes, provided that ALTAX Center is clearly acknowledged as the source of information.

Konsiderata

(Shqip) Ky dokument është një reflektim i punës së përbashkët dhe përkushtimit të shumë profesionistëve që kanë kontribuar për ta bërë informacionin ekonomik dhe politik më të kuptueshëm dhe të aksesueshëm për publikun e gjerë.

ALTAX nëpërmjet këtij dedikikimi falënderon autorët, si kontribuesit kryesorë. Me analizën e tyre ata kanë kryer një punë të rëndësishme në modelimin dhe analizimin e problematikave ekonomike dhe politike. Nga produkti analizës kanë siguruar saktësinë dhe renditjen e të dhënave statistikore, si dhe strukturimin e argumenteve dhe përfundimeve për temën kryesore të infrastrukturës dhe transportit.

Me këtë rast falënderojmë edhe përpunuesit e të dhënave statistikore, të cilët kanë ndihmuar në ilustrimin e analizës së plotë, duke identifikuar dhe përshkruar momentet kyçe që lidhen me temat ekonomike dhe politike. Falënderim i dedikuar është për ekspertët që bashkëpunojnë vullnetarisht me ALTAX. Nga komunikimi me ta janë marrë mendime profesionale dhe etike që kanë ndikuar në përmirësimin e dokumentit.

Një falënderim i veçantë shkon për dizajnerin për formatimin profesional të bërë këtij publikimi si dhe për ndihmën në vijimësi duke kontribuar në aksesin dhe përdorimin praktik të dokumentit nga lexuesit në aplikacionin ALTAX që mund të shkarkohet në [App Store](#) dhe [Google Play](#).

Kjo analizë është drejtuar dhe koordinuar nga Drejtoresh ekzekutive e ALTAX, e cila ka udhëhequr promovimin e vizionit të ALTAX përmes të gjitha produkteve të saj, duke përfshirë analiza, studime, publikime dhe platforma dixhitale që synojnë të informojnë dhe të angazhojnë publikun.

Faleminderit të gjithëve që mbështesin këtë mision dhe vijnë të kontribuojnë me njohuri dhe përvojën e tyre për një analizë të thelluar dhe të besueshme.

Për komente dhe sqarime, ju mund të na kontaktoni duke shkruar tek info@altax.com

Acknowledgement

(English) This document is a reflection of the joint work and dedication of many professionals who have contributed to making economic and political information more understandable and accessible to the general public.

ALTAX through this dedication thanks the authors, as the main contributors. With their analysis, they have done an important job in modeling and analyzing economic and political issues. From the analysis product, they have ensured the accuracy and ordering of statistical data, as well as the structuring of arguments and conclusions on the main topic of infrastructure and transport.

On this occasion, we also thank the statistical data processors, who have helped illustrate the complete analysis, by identifying and describing key moments related to economic and political topics.

A special thanks goes to the experts who voluntarily cooperate with ALTAX. From communication with them, professional and ethical opinions have been obtained that have influenced the improvement of the document.

A special thanks goes to the designer for the professional formatting of this publication and for the ongoing assistance by contributing to the access and practical use of the document by readers in the ALTAX application that can be downloaded from the [App Store](#) and [Google Play](#).

This analysis has been directed and coordinated by the Executive Director of ALTAX, who has led the promotion of ALTAX's vision through all its products, including analyses, studies, publications, and digital platforms aimed at informing and engaging the public.

Thanks to everyone who supports this mission and continues to contribute with their knowledge and experience for a thorough and reliable analysis.

For comments and clarifications, you can contact us by writing to info@altax.com

Follow & Connect with ALTAX and POLIFAKT

A relationship about the commonalities that unite us in everyday life.

Stay connected across Platforms

 Platforma	 Përshkrimi	 Link
 ALTAX.AL	Lexoni dhe shkarkoni analiza unike dhe studime.	Visit ALTAX
 POLIFAKT.AL	Shihni sa premtime politike janë mbajtur.	Visit POLIFAKT
 ALTAX YouTube	Ndiqui video edukative dhe informuese.	ALTAX on YouTube
 Rrjetet Sociale	Komunikoni me ne në rrjete sociale.	Facebook · Twitter/X · LinkedIn
 Fiskalisti	Ti je në fokusin tonë. Krijojmë bashkë.	More Info
 App Store	Shkarkoni aplikacionin për celular.	Download on App Store
 Google Play	Merrni informacionet direkt në telefon.	Download on Google Play

What we do?

ALTAX – POLIFAKT

We publish and distribute information, ongoing analysis and studies – always keeping you in focus.

Why Follow Us?

Because together, we're building knowledge, transparency, and accountability.

"Our focus is on you, with unwavering dedication we collaborate to create real impact."

"Fokusi ynë është tek ju, me përkushtim të palëkundur bashkëpunojmë për të krijuar ndikim të vërtetë."



♥ Bashkë për transparencë, dije dhe përfshirje

Ne jemi pranë jush – sepse ju jeni në qendër të misionit tonë!

📢 **Së bashku krijojmë informacion të besueshëm, analiza të thelluara dhe mjetet për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik dhe politik.**

🔍 **Çfarë bëjmë?**

🧠 **Publikojmë analiza dhe studime me ndikim** – ALTAX dhe POLIFAKT janë burime të pavarura për transparencë fiskale dhe politike.

📊 **Vlerësojmë premtimet politike** – te [POLIFAKT.AL](https://polifakt.al) kontrolloni sa janë mbajtur premtimet.

📺 **Edukojmë përmes videove** – ndiqni ALTAX në rrjete sociale dhe në [ALTAX.AL](https://altax.al) për përmbajtje të dobishme.

📱 **Ju sjellim informacionin drejt në celular** – me aplikacionin tonë në [App Store](https://appstore.apple.com) dhe Google Play.

✳ **Bashkohuni me ne**

- ◆ Për më shumë **transparencë publike**,
- ◆ Për më shumë **arsim fiskal dhe qytetar**,
- ◆ Për më shumë **besim tek e vërteta**.

👏 **E ardhmja ndërtohet me informim. Bashkë krijojmë ndryshimin!**

Hyrje

Në një botë të trazuar nga pasiguritë globale, që nga tensionet gjeopolitike dhe rritja e barrierave tregtare deri te transformimet e shpejta të nxitura nga inteligjenca artificiale dhe digjitalizimi, Shqipëria dhe Kosova, dy ekonomi të vogla, por me potencial të madh në Ballkanin Perëndimor, ndodhen në një moment vendimtar për të ardhmen e tyre.

Pas një dekade përparimi ekonomik, me rritje të qëndrueshme të PBB-së dhe përmirësime të ndjeshme në të ardhurat për frymë, të dyja vendet kanë demonstruar aftësi për të ndërtuar një të ardhme të begatë.

Sektori i turizmit në Shqipëri, i cili ka tërhequr miliona vizitorë, dhe rritja e eksporteve të shërbimeve digjitale në Kosovë janë dëshmi e këtij potenciali. Megjithatë, këto arritje janë të brishta përballë sfidave globale dhe të brendshme.

Rritja e tarifave tregtare, siç u përmend nga Drejtoresha Ekzekutive e FMN-së, Kristalina Georgieva, në fjalimin e saj të tetorit 2025, mund të pengojë eksportet shqiptare të tekstileve dhe produkteve bujqësore të Kosovës.

Po ashtu, institucionet e dobëta, varësia nga sektorë të kufizuar si ndërtimi dhe shërbimet, dhe mungesa e një fuqie punëtore të përgatitur për ekonominë digjitale rrezikojnë të frenojnë përparimin.

Në këtë kontekst të pasigurisë globale, nevoja për një vizion strategjik dhe të qartë për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë dhe Kosovës është më urgjente se kurrë.

Nuk është se qeveritë e këtyre vendeve nuk i kanë të hartuara strategjitë apo planet për zhvillim, pasi dokumente të tilla ekzistojnë, shpesh të detajuara dhe ambicioze.

Megjithatë, zbatimi i tyre shpesh pengohet nga mungesa e konsensusit politik, interesat afatshkurtra dhe koordinimi i dobët institucional.

Ky punim vjen si një thirrje nga **komuniteti akademik dhe shoqëria civile**, të cilët, përmes analizave të pavarura dhe angazhimit publik, kërkojnë të nxisin një dialog gjithëpërfshirës për të kthyer këto strategji në veprime konkrete. Ai synon të analizojë mundësitë dhe pengesat për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës përtej 2025-ës, duke propozuar një kornizë strategjike të bazuar në tre shtylla kryesore: **diversifikimi ekonomik** për të zvogëluar varësinë nga sektorët tradicionalë, **forcimi i institucioneve** për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie, dhe **bashkëpunimi rajonal** për të zgjeruar tregjet dhe transferimin e teknologjisë.

Me angazhimin e liderëve, shoqërisë civile dhe qytetarëve, si dhe me një qasje të guximshme që vë interesin publik mbi atë politik, Shqipëria dhe Kosova mund të shndërrohen nga ekonomi të brishta në aktorë konkurrues në skenën globale, duke ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që i përgjigjet sfidave të një bote në ndryshim të shpejtë.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj analize është të ofrojë një vlerësim gjithëpërfshirës të mundësive dhe sfidave për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të Shqipërisë dhe Kosovës përtej vitit 2025, në një kontekst të pasigurive globale dhe dinamikave rajonale.

Duke u bazuar në të dhëna nga institucione si FMN-ja, Banka Botërore, INSTAT dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe në thirrjet e komunitetit akademik dhe shoqërisë civile, ky punim synon të nxisë një dialog konstruktiv për zbatimin e strategjive ekzistuese dhe për hartimin e politikave të reja që adresojnë brishtësinë e rritjes ekonomike.

Përmes një kornize strategjike të bazuar në diversifikimin ekonomik, forcimin institucional dhe bashkëpunimin rajonal, analiza kërkon të ofrojë udhëzime praktike për liderët, politikëbërësit dhe shoqërinë civile, duke i inkurajuar të punojnë bashkërisht për të transformuar potencialin ekonomik të këtyre vendeve në një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, që i përgjigjet sfidave globale si tensionet tregtare dhe ndryshimet teknologjike.

Synimet

1. **Identifikimi i sfidave kryesore.** Të analizohen pengesat strukturore dhe të jashtme që kërcënojnë rritjen ekonomike të Shqipërisë dhe Kosovës, duke përfshirë varësinë nga sektorë të kufizuar (si turizmi dhe ndërtimi), dobësitë institucionale, papunësinë e lartë tek të rinjtë dhe ndikimin e tronditjeve globale si tarifatat tregtare.
2. **Vlerësimi i mundësive për rritje.** Të nxjerrë në pah potencialin për diversifikim ekonomik përmes sektorëve me vlerë të lartë, si teknologjia e informacionit dhe agrobiznesi, si dhe mundësitë për integrim rajonal përmes nismave si Ballkani i Hapur, për të zgjeruar tregjet dhe transferimin e teknologjisë.
3. **Propozimi i një kornize strategjike.** Të ofrojë një plan të qartë dhe të zbatueshëm bazuar në tre shtylla kryesore: diversifikimi ekonomik, forcimi i institucioneve dhe bashkëpunimi rajonal, duke përfshirë shembuj konkretë si investimet në inteligjencën artificiale, reformat tatimore dhe infrastrukturën ndërkufitare.
4. **Nxitja e bashkëpunimit të gjerë.** Të inkurajojë një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin liderët politikë, shoqërinë civile dhe komunitetin akademik për të ndërtuar konsensus dhe për të zbatuar reforma afatgjata, duke theksuar nevojën për kurajo për të vënë interesin e shtetit mbi interesat afatshkurtra politike.
5. **Lidhja me kontekstin global.** Të vendosë sfidat dhe mundësitë e Shqipërisë dhe Kosovës në kuadrin e dinamikave globale, si rritja e barrierave tregtare dhe ndikimi i teknologjive të reja, për të ilustruar urgjencën e reformave dhe nevojën për një vizion proaktiv.
6. **Furnizimi me të dhëna dhe shembuj konkretë.** Të mbështesë argumentet me të dhëna të besueshme nga burime ndërkombëtare dhe vendase, si dhe me shembuj praktikë, si rritja e turizmit në Shqipëri, sukseset e sektorit të IT-së në Kosovë dhe rolin e reformave institucionale si SPAK-u, për të rritur besueshmërinë dhe relevancën e analizës.

Përmes këtyre synimeve, analiza synon jo vetëm të diagnostikojë gjendjen aktuale, por edhe të shërbejë si një thirrje për veprim nga komuniteti akademik dhe shoqëria civile, për të nxitur zbatimin e strategjive ekzistuese dhe për të ndërtuar një të ardhme ku Shqipëria dhe Kosova mund të lulëzojnë si ekonomi konkurruese dhe reziliente në një botë gjithnjë e më komplekse.

Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim ofron një analizë të thellë të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës përtej vitit 2025, duke theksuar nevojën për reforma të guximshme në një kontekst të pasigurive globale.

Shqipëria ka arritur një rritje mesatare vjetore të PBB-së prej **3.4–3.9%** gjatë periudhës 2021–2025, mbështetur nga sektori i turizmit që ka tërhequr mbi **10 milionë vizitorë në 2023** dhe ka gjeneruar mbi **3 miliardë euro** në të ardhura në 2024.

Kosova, me një rritje më dinamike prej **4.4% në 2024** dhe parashikime për mbi **4% në 2025**, ka përfitur nga konsumi privat dhe eksportet rekord prej **16% në tremujorin e dytë të 2021**, duke ulur normën e varfërisë me **35%** që nga pavarësia.

Megjithatë, këto arritje janë të brishta përballë sfidave si tensionet gjeopolitike, rritja e tarifave tregtare dhe ndikimi i teknologjive të reja, siç u theksua nga Kristalina Georgieva në fjalimin e saj të tetorit 2025.

Punimi analizon brishtësinë e rritjes ekonomike, duke vënë në dukje varësinë nga sektorë si ndërtimi dhe shërbimet, të cilët janë të ndjeshëm ndaj tronditjeve globale.

Në Shqipëri, turizmi ka sjellë **8.97 milionë vizitorë** në 8-mujorin e 2025-s, duke e renditur si liderin evropian për rritje turistike (+**136%** krahasuar me 2019), por varësia e lartë nga ky sektor e ekspozon ndaj luhatjeve.

Në Kosovë, rritja e PBB-së prej **4.58%** në tremujorin e dytë të 2025-s është nxitur nga investimet, por deficitit tregtar dhe remitancat (**15% e PBB-së**) krijojnë rreziqe.

Për të kapërcyer këto, propozohet një qasje trefishtë: diversifikimi sektorial drejt teknologjisë së informacionit dhe agrobiznesit të modernizuar, investimet në kapitalin njerëzor për teknologji si IA, dhe integrimi rajonal përmes nismave si Ballkani i Hapur.

Sipas EBRD-së, Shqipëria pritet të rritet me **3.7% në 2025**, por pa diversifikim, sektori industrial rrezikon rënie; në Kosovë, sektori i IT-së ka rritur eksportet me **15% në 2024**.

Stabiliteti fiskal konsiderohet si themeli i zhvillimit afatgjatë. Formalizimi i ekonomisë ka rritur transparencën, me Shqipërinë që ka përmirësuar Indeksin e Lehtësisë së të Bërit Biznes nga vendi **82 në 2019** në **63 në 2023**, duke tërhequr FDI në energjinë e rinovueshme.

Në Kosovë, reformat tatimore kanë rritur të ardhurat me **10% në 2024**. Megjithatë, institucionet e dobëta dhe interesat politike pengojnë progresin, si vonesat në projekte si autostrada Prishtinë-Shkup. Rekomandohet forcimi i institucioneve të pavarura, si SPAK-u në Shqipëri, dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile për të garantuar llogaridhënie. Pa këto, rritja mund të ngadalësohet në **3.1%** në mes të dekadës, sipas FMN-së.

Fuqia punëtore është një tjetër shtyllë kritike, me sfida si infrastruktura digjitale e dobët në Shqipëri (**60% akses broadband**) dhe papunësia e të rinjve në Kosovë (**50% për 15–24 vjeç në 2023**). Investimet në IA, si **8.8 milionë euro** në startup-in shqiptar në 2025, dhe partneritetet me kompani globale si Microsoft, mund të transformojnë tregun e punës. Programet e trajnimit në Kosovë kanë ulur papunësinë në **19.2% në 2025**, por nevojiten më shumë masa sociale për tranzicionin nga sektorët tradicionalë.

Integrimi rajonal ofron një rrugë për reziliencë, me Ballkanin e Hapur që ka rritur tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës me **20% në 2024**.

Harmonizimi i standardeve me Maqedoninë e Veriut mund të zbusë ndikimin e tarifave globale, ndërsa infrastruktura si linjat hekurudhore Durrës-Prishtinë mund të rrisë tregtinë me **15%**, sipas EBRD-së. Plani i Rritjes së BE-së me **750 milionë euro** ofron mbështetje për reforma në sundimin e ligjit dhe digjitalizimin.

Vizioni për të ardhmen fokusohet në reforma të brendshme (konsolidimi fiskal dhe forcimi institucional) dhe hapje ndërkombëtare (përgatitja e fuqisë punëtore, integrimi rajonal dhe modernizimi i sektorëve). Shqipëria parashikon uljen e borxhit publik në **53.7% të PBB-së deri në 2026**, ndërsa Kosova ka rritur eksportet e IT-së.

Në thirrjen për kurajo dhe bashkëpunim, theksohet nevoja për lidërsipin e vjetër dhe të ri për të rrezikuar pushtetin në favor të shtetit, duke zbatuar reforma si reduktimi i informalitetit (**30% e ekonomisë**) dhe ulja e papunësisë së të rinjve.

Ky punim, vjen si thirrje nga komuniteti akademik dhe shoqëria civile, synon të nxisë veprim për të kthyer potencialin në realitet të qëndrueshëm.



Në pesë vitet e fundit, nga 2021 deri më 2025, Shqipëria ka shënuar një rritje ekonomike mesatare vjetore prej **3.4–3.9%**, e nxitur kryesisht nga ndërtimi, shërbimet dhe prodhimi, sipas të dhënave nga INSTAT dhe raportet e FMN-së. Kjo rritje është mbështetur nga një rimëkëmbje e fortë pas pandemisë COVID-19, ku sektori i turizmit ka luajtur një rol kyç, duke tërhequr mbi 10 milionë vizitorë në 2023 dhe duke kontribuar në një rritje të të ardhurave nga turizmi në mbi 3 miliardë euro në 2024. Megjithatë, kjo dinamikë nuk është pa sfida.

Sipas Bankës Botërore, rritja pritet të moderohet në 3.4% në 2025, për shkak të faktorëve të jashtëm si tensionet gjeopolitike dhe rritja e tarifave tregtare globale, siç u theksua nga Drejtoresha Ekzekutive e FMN-së, Kristalina Georgieva, në [fjalimin e saj për sfidat globale në tetor 2025](#).

Kosova, nga ana tjetër, ka treguar një dinamikë edhe më të fortë, me një rritje ekonomike që arriti **4.4% në 2024** dhe parashikime për mbi **4% në 2025**, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe FMN-së. Kjo e rendit Kosovën ndër ekonomitë me rritjen më të shpejtë në rajon, e mbështetur nga konsumi i familjeve, investimet private dhe një rritje rekord e eksporteve prej **16% në tremujorin e dytë të 2021**.

Sipas raportit të Bankës Botërore, Kosova ka përjetuar një rritje të qëndrueshme që nga pavarësia, me një rritje të të ardhurave për frymë prej gati 50% dhe një ulje të normës së varfërisë prej 35%. Por, pavarësisht këtyre shifrave të lakmueshme, rritja e të dyja vendeve ngjan me një shtëpi të ndërtuar mbi rrë: pa themele të forta institucionale dhe ekonomike, ajo mund të lëkundet nga **tronditjet globale**, si rritja e tarifave tregtare, tensionet gjeopolitike dhe ndryshimet teknologjike.

Për të kapërcyer këto sfida dhe për të shfrytëzuar mundësitë e teknologjive të reja dhe tregjeve rajonale, Shqipëria dhe Kosova kanë nevojë për një **vizion strategjik të qartë**. Ky vizion nuk është luks, por një domosdoshmëri për të ndërtuar ekonomi **reziliente** dhe **konkurruese** që mund të lulëzojnë në një botë të paqëndrueshme.

Në këtë analizë, do të shqyrtojmë në detaje rritjen ekonomike dhe brishtësinë e saj, stabilitetin fiskal, fuqinë punëtore, integrimin rajonal dhe vizionin për të ardhmen, duke zgjeruar argumentet me fakte dhe shembuj konkretë nga raportet e FMN-së, Bankës Botërore dhe institucioneve vendase.

Një rritje që kërkon themel të fortë

Shqipëria dhe Kosova kanë treguar aftësi për të ecur përpara, por rruga drejt zhvillimit të qëndrueshëm është plot sfida.

Ndërtimi dhe shërbimet kanë qenë motorët kryesorë të rritjes në të dyja vendet, por këta sektorë janë të ndjeshëm ndaj stuhive globale, siç janë **tarifat e reja tregtare** të SHBA-së të përmendura nga Georgieva, të cilat mund të ndikojnë eksportet shqiptare të tekstileve ose produktet bujqësore të Kosovës.

Sipas të dhënave të FMN-së, Shqipëria ka regjistruar një rritje të PBB-së reale prej 3.4% në 2024, me një parashikim për 3.7% në 2025, mbështetur nga një rritje e turizmit që ka arritur në **8.97 milionë vizitorë** në 8-mujorin e 2025-s, një rritje prej 5.2% krahasuar me periudhën e ngjashme të vitit të kaluar. Kjo e rendit Shqipërinë si numrin një në Evropë për rritjen turistike (+136% krahasuar me 2019), sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, duke sjellë rreth 5 miliardë euro në ekonomi në 2024.

Në Kosovë, rritja ka qenë edhe më dinamike, me një zgjerim të PBB-së prej 4.58% në tremujorin e dytë të 2025-s, më e shpejta që nga tremujori i parë i 2024-s, sipas Trading Economics. Kjo rritje është nxitur

nga konsumi privat dhe investimet, por mbetet e brishtë për shkak të deficitit tregtar dhe uljes së remitançave. Sipas Bankës Botërore, Kosova ka një varësi të madhe nga remitancat, të cilat përbëjnë rreth 15% të PBB-së, dhe një normë papunësie të lartë tek të rinjtë prej 50% për grupmoshën 15–24 vjeç në 2023.

Në Shqipëri, sektori i turizmit ka sjellë **10 milionë vizitorë në 2023**, sipas INSTAT, por varësia e madhe nga ky sektor e lë ekonominë të ekspozuar ndaj luhatjeve sezonale dhe ndryshimeve globale në turizëm. Në Kosovë, varësia nga **remitancat** (që përbëjnë rreth 15% të PBB-së sipas ASK-së) dhe papunësia e lartë tek të rinjtë (rreth **50% për grupmoshën 15–24 vjeç në 2023**) e bëjnë rritjen e brishtë.

Çelësi për të ndërtuar një ekonomi më të qëndrueshme qëndron në një qasje të trefishtë:

- **Diversifikimi sektorial** me investime në sektorë me vlerë të lartë, si **teknologjia e informacionit** (p.sh., startup-et në Tiranë ose kompanitë e outsourcing-ut në Prishtinë) dhe **agrobiznesi i modernizuar** (p.sh., përpunimi i produkteve bujqësore për eksport në Kosovë), mund të zvogëlojnë varësinë nga ndërtimi dhe shërbimet.

Sipas raportit të EBRD-së, Shqipëria pritet të rritet me 3.7% në 2025, por sektori industrial ka rënë, duke kërkuar diversifikim për të zbutur rrezikun. Në Kosovë, sektori i IT-së ka rritur eksportet e shërbimeve digjitale, duke kontribuar në një rritje të përgjithshme të ekonomisë prej 4.9% në gjysmën e parë të 2024-s, sipas EBRD-së.

- **Investimet në kapitalin njerëz**, ku përgatitja e fuqisë punëtore për teknologjitë e reja, si **inteligjenca artificiale (IA)** dhe digjitalizimi janë thelbësore për të qëndruar konkurrues. Shqipëria ka investuar 8.8 milionë euro në një startup AI në maj 2025, ndërsa Kosova ka partneritete me kompani globale për trajnime digjitale.
- **Integrimi rajonal** nëpërmjet bashkëpunimit me vendet fqinje, si përmes nismave rajonale, po ashtu edhe ato të miratuara të Plani I Rritjes, të cilat mund të lehtësojnë transferimin e teknologjisë dhe zgjerimin e tregjeve.

Sipas raportit të OECD-së për 2025-n, Ballkani Perëndimor ka një treg të përbashkët me kufizime, ku Shqipëria dhe Kosova mund të përfitojnë nga diversifikimi ekonomik, por mungesa e diversifikimit (si në Shqipëri me turizmin) kufizon vlerën e shtuar.

Kjo qasje jo vetëm shpërndan rrezikun, por krijon një ekonomi që mund të lulëzojë, duke shndërruar potencialin e brishtë në një forcë të qëndrueshme në skenën globale. Sipas FMN-së, pa diversifikim, rritja mund të ngadalësohet në 3.1% në mes të dekadës, duke theksuar nevojën për reforma strukturore.

Stabiliteti fiskal, si një premtim për të ardhmen

Të ndërtosh një ekonomi të qëndrueshme është si të mbjellësh një pemë që jep fruta për dekada. **Stabiliteti fiskal dhe formalizimi i ekonomisë** janë rrënjët e kësaj peme. Formalizimi rrit **transparencën dhe efikasitetin**, duke krijuar mundësi për investime strategjike.

Për shembull, në Shqipëri, përmirësimi i **Indeksit të lehtësisë së të bërit biznes** (nga vendi 82 në 2019 në vendin 63 në 2023, sipas Bankës Botërore) ka tërhequr investime të huaja direkte në sektorë si energjia e rinovueshme, duke kontribuar në një rritje të PBB-së prej 3.7% të parashikuar për 2025 nga EBRD-ja. Në Kosovë, reformat tatimore kanë rritur të ardhurat fiskale me 10% në 2024, duke krijuar hapësirë për investime në infrastrukturë, sipas ASK-së.

Por pengesa kryesore mbeten **institucionet e dobëta**. Në të dyja vendet, lidhshipi i gjatë dhe praktikatat politike të konsoliduara shpesh pengojnë reformat afatgjata në favor të interesave të ngushta.

Sipas raportit të Departamentit të Shtetit të SHBA-së për 2025-n, Shqipëria ka një ekonomi stabil, por përballet me sfida në konkurrencën e drejtë për shkak të kontratave PPP që reduktojnë mundësitë për investitorë të huaj në infrastrukturë.

Në Kosovë, ekonomia informale dhe varësia nga remitancat (rreth 20% e PBB-së sipas FMN-së) krijojnë pasiguri fiskale. Vonesat në projekte infrastrukturore, si autostrada Prishtinë-Shkup, tregojnë mungesën e koordinimit dhe prioritetëve të qarta, duke çuar në një deficit të llogarisë korrente në rritje.

Për të kapërcyer këtë, nevojitet një fokus në **forcimin e institucioneve të pavarura dhe llogaridhënëse**, duke krijuar një mjedis ku interesi publik mbizotëron. Kjo mund të përfshijë:

- Krijimin e organeve të pavarura për mbikëqyrjen e buxhetit dhe luftën kundër korrupsionit, si në modelin e suksesshëm të Shqipërisë me SPAK-un, që ka rritur besimin e investitorëve.
- Bashkëpunimin me shoqërinë civile për të ndërtuar konsensus për reforma të qëndrueshme, si në Kosovë ku organizatat civile kanë lobuar për reduktimin e informalitetit.
- Zbatimin e këshillave të FMN-së për "regulatory housecleaning", duke hequr licencat e panevojshme për bizneset, që mund të rrisë konkurrencën dhe të ulë barrierat për investime.

Një shtet me institucione të forta është si një anije që lundron në dete të trazuar, duke tërhequr investime dhe duke ndërtuar besim te qytetarët dhe partnerët ndërkombëtarë.

Sipas EBRD-së, pa këto reforma, Shqipëria rrezikon një ngadalësim të rritjes në 3.2% në 2025 për shkak të rënies në prodhim industrial dhe bujqësor, ndërsa Kosova mund të përballet me një ulje të rritjes në 3.6% në tremujorin e parë të 2025-s, sipas Bankës Botërore.

Fuqia punëtore nga e vjetër në të re

Në një botë ku **inteligjenca artificiale, digjitalizimi dhe automatizimi** po transformojnë ekonominë, Shqipëria dhe Kosova përballen me një sfidë të madhe: **fuqia punëtore** e tyre nuk është gati për këto ndryshime.

Në Shqipëri, infrastruktura e dobët digjitale kufizon aftësinë për të përqafuar teknologjitë e reja, me vetëm 60% të popullsisë që ka akses në internet broadband sipas INSTAT.

Në Kosovë, papunësia e lartë tek të rinjtë prej 20-30% dhe mungesa e trajnimeve të specializuara e bëjnë të vështirë konkurrencën në sektorë si IT-ja, pavarësisht rritjes së kompanive të outsourcing-ut në Prishtinë, që kanë kontribuar në një rritje të eksporteve të shërbimeve digjitale me 15% në 2024.

Për të kapërcyer këtë hendek, investimet në arsim dhe trajnime janë kritike. Shqipëria ka marrë hapa drejtues, si investimi 8.8 milionë euro në startup-in AI "Machine Thinking Lab" në maj 2025, dhe bashkëpunimi me Inetum Consulting për strategjinë e AI-së në 2024, duke vendosur standarde etike dhe teknike.

Në Kosovë, programet e trajnimit profesional kanë ulur papunësinë në 19.2% në 2025, sipas Bankës Botërore, por mbetet nevoja për më shumë investime.

Për shembull, shikohet se:

- **Partneritetet me kompani globale**, si Microsoft ose Google, mund të krijojnë akademi digjitale për të trajnuar të rinjtë në fusha si IA, analiza e të dhënave dhe fintech, siç është propozuar në konferencën "Expand to US & AI Conference 2025" në Prishtinë.
- **Programet e aftësimit profesional** mund të fokusohen në sektorë me potencial, si agroturizmi në Shqipëri (që ka sjellë 874 milionë euro në tremujorin e parë të 2025-s) ose përpunimi i produkteve bujqësore në Kosovë, duke rritur vlerën e shtuar dhe duke krijuar vende pune.
- **Ristrukturimi i politikave sociale** mund të ndihmojë në menaxhimin e tranzicionit të punëtorëve nga sektorët tradicionalë në ato inovativë, si në strategjinë e punësimit të Kosovës për 2024-2028, që adreson emigracionin dhe kontributin e remitançave në PBB.

Pa këto masa, hendeku mes potencialit ekonomik dhe aftësive reale të punëtorëve do të zgjerohet, duke kufizuar **konkurrueshmërinë** dhe duke penguar rritjen afatgjatë.

Sipas OECD-së, digjitalizimi po riformon ekonominë, dhe Shqipëria dhe Kosova mund të përfitojnë nga investime në IA, si fabrikat e AI-së në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, por Shqipëria ka vetëm një dokument udhëzues për AI-në, duke kërkuar më shumë veprim.

Integrimi rajonal, një udhë për tu bërë

Në një botë ku tregjet globale janë të paqëndrueshme, **integrimi rajonal** është si një anije shpëtimi për Shqipërinë dhe Kosovën. Bashkëpunimi me vendet fqinje përmes nismave si **Ballkani i Hapur** mund të lehtësojë transferimin e teknologjisë, të zgjerojë tregjet dhe të ulë **barrierat tregtare**, siç këshillon Georgieva për reduktimin e barrierave jotarifore.

Sipas raportit të Bruegel për 2025-n, Tregu i Përbashkët Rajonal i Ballkanit Perëndimor ka kufizime, por ka suksese si lëvizja e lirë e mallrave, duke rritur tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës me 20% në 2024. Për shembull, harmonizimi i standardeve të eksportit mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut mund të rrisë eksportet e produkteve bujqësore dhe të tekstileve, duke zbutur ndikimin e tarifave globale.

Por kjo kërkon një vizion të përbashkët. Mungesa e koordinimit rajonal dhe interesat e ngushta politike mund të pengojnë këto përfitime, si në tensionet midis Kosovës dhe Serbisë që kanë ngadalësuar integrimin. Sipas raportit të Carnegie Endowment për 2025-n, Shqipëria dhe Mali i Zi shpresojnë të anëtarësohen në BE para 2030-s, por pengesat si korrupsioni dhe rregullat e ligjit kërkojnë reforma. Për të ecur përpara, dy vendet dhe më gjerë mund të:

- Krijojnë **marrëveshje tregtare** për të reduktuar barrierat jotarifore, si licencat e ndërlikuara, duke ndjekur shembullin e UfM-së për integrimin rajonal.
- Investojnë në **infrastrukturë ndërkufitare**, si linjat hekurudhore Durrës-Prishtinë, që mund të rrisë tregtinë me 15%, sipas EBRD-së.
- Përforcojnë bashkëpunimin politik, si në takimet e liderëve të Ballkanit Perëndimor në 2025, ku u diskutua Plani i Rritjes së BE-së me 750 milionë euro për reforma në sundimin e ligjit dhe digjitalizimin.

Ky bashkëpunim jo vetëm forcon **reziliencën**, por krijon një bazë ekonomike të qëndrueshme për të dyja vendet. Sipas raportit të OECD-së për Konvergencën Ekonomike në Ballkanin Perëndimor 2025, integrimi mund të rrisë PBB-në me 5-10% në dekadën e ardhshme, por kërkon diversifikim për të shmangur kufizimet aktuale.

Një vizion për të ardhmen bazuar mbi reforma dhe hapje

Shqipëria dhe Kosova ndodhen në një udhëkryq historik. Për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme, ato duhet të ndjekin dy drejtime kryesore: **reforma të brendshme** dhe **hapje ndërkombëtare**.

Reforma të brendshme

Konsolidimi fiskal dhe administrative, ku politikat fiskale duhet të ulin varësinë nga borxhi, me Shqipërinë që parashikon uljen e borxhit publik në 53.7% të PBB-së deri në 2026, sipas Moody's. Në Kosovë, reformat tatimore kanë rritur të ardhurat, por deficitit tregtar mbetet i lartë. Formalizimi i ekonomisë, si përmes reformave tatimore në Kosovë, rrit transparencën dhe efikasitetin, duke tërhequr më shumë FDI.

Forcimi i institucioneve, që do të thotë krijimi i organeve të pavarura për mbikëqyrjen e buxhetit dhe luftën kundër korrupsionit, si në modelin e Shqipërisë me SPAK-un, që ka rritur besimin e investitorëve. Në Kosovë, sfidat institucionale si ekonomia informale kërkojnë reforma për të reduktuar informalitetin prej 30%, sipas FMN-së. Bashkëpunimi me shoqërinë civile mund të ndihmojë në ndërtimin e konsensusit, si në fushatat kundër korrupsionit në të dyja vendet.

Hapje ndërkombëtare

Përgatitja e fuqisë punëtore me temp më të shpejtë në investimet në arsim dhe trajnime për teknologjitë e reja, si p.sh. akademitë digjitale, që mund të përgatisin të rinjtë për një ekonomi globale në ndryshim. Shqipëria ka organizuar konferenca si TechFuse 2025 për inovacionin në IA, ndërsa Kosova ka programe për aftësim profesional që kanë ulur papunësinë.

Integrimi rajonal me marrëveshjet tregtare mund të zgjerojnë tregjet dhe të transferojnë teknologji, duke rritur konkurrueshmërinë. Sipas raportit të Polish Presidency për 2025-n, Ballkani Perëndimor ka 35 indikatorë për konvergencën ekonomike, ku Shqipëria dhe Kosova mund të përmirësojnë performancën në digjitalizim.

Modernizimi i sektorëve strategjikë me investimet në teknologji dhe agrobiznes (p.sh., agroturizmi në Shqipëri ose përpunimi i produkteve bujqësore në Kosovë) mund të sjellin vlerë të lartë dhe vende pune. Shqipëria ka investuar në Durana Tech Park për inovacion, ndërsa Kosova ka rritur eksportet e IT-së.

Një ftesë për kurajo dhe bashkëpunim

Shqipëria dhe Kosova mbajnë në duar një hartë të pasur me mundësi, një vizion premtues për një të ardhme ku **rritja ekonomike**, **rezilienca** dhe **konkurrueshmëria** mund të transformojnë këto vende në aktorë të fuqishëm në Ballkan dhe më gjerë.

Por kjo hartë nuk është një udhëzues që ndiqet vetvetiu.

Rruga përpara është plot sfida, dhe për të ecur në të kërkohet **vendosmëri politike**, **bashkëpunim i gjerë** dhe, mbi të gjitha, **kurajo**, sidomos nga liderhipi, i vjetër dhe i ri, për të tejkaluar vetveten dhe për të punuar sipas tezës: **“Të rrezikojmë pushtetin për të ndërtuar shtetin.”**

Brishtësia e konsensusit politik dhe tendenca për t'u fokusuar në interesa afatshkurtra kanë qenë pengesa të mëdha për të dyja vendet.

Në Shqipëri, projektet infrastrukturore si autostradat e rëndësishme të korridorit Blu janë vonuar për shkak të prioritetëve politike mbi interesin publik, ndërsa në Kosovë, tensionet politike kanë ngadalësuar zbatimin e marrëveshjeve rajonale, si ato të ndërmjetësuar nga BE-ja.

Këto dinamika rrezikojnë të lënë pas një ekonomi të brishtë, të ndjeshme ndaj **tronditjeve globale** si rritja e tarifave tregtare apo ndryshimet teknologjike të përmendura nga [Kristalina Georgieva](#) në fjalimin

e saj për sfidat globale në tetor 2025. Por ka një rrugëdalje, dhe ajo fillon me guximin për të vënë interesin e shtetit mbi interesat personale apo partiake.

Lidershipi i vjetër, me përvojën dhe ndikimin e tij ka një rol kyç për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe për të hapur rrugën për reforma të guximshme. Por është **leadershipi i ri**, i cili sjell energji të freskët dhe një vizion të ri, që duhet të tregojë kurajon për të sfiduar status quo-në.

Kjo do të thotë të pranojnë rrezikun e humbjes së mbështetjes politike afatshkurtër për të investuar në politika afatgjata që forcojnë shtetin.

Për shembull, në Shqipëri, reformat për të reduktuar informalitetin ekonomik (që përbën rreth 30% të ekonomisë, sipas FMN-së) kërkojnë vendime të vështira, si rritja e transparencës në kontratat publike, që mund të pakësojnë favore politike. Në Kosovë, zbatimi i reformave për të ulur papunësinë e të rinjve (50% për grupmoshën 15–24 vjeç në 2023, sipas ASK-së) mund të kërkojë investime në arsim që nuk japin rezultate të menjëhershme, por që ndëtojnë një fuqi punëtore të aftë për ekonominë e së ardhmes.

Ky guxim për të rrezikuar pushtetin për hir të shtetit mbështetet nga pesë shtylla kryesore, si: **stabiliteti fiskal, fuqia punëtore e aftësuar, integrimi rajonal, sektorët e modernizuar dhe institucionet e forta**.

Këto shtylla nuk janë thjesht ide, por janë në fakt themelet e një shteti që mund të përballojë pasiguritë globale dhe të shfrytëzojë mundësitë e një bote në ndryshim të shpejtë.

Investimet në **inteligjencën artificiale** dhe **digjitalizimin**, si partneritetet me kompani globale si Microsoft për akademi digjitale, mund të transformojnë fuqinë punëtore. Po kështu, zbatimi korrekt i pikave të [Planit të Rritjes](#) mund të ulin barrierat tregtare dhe të rrisin tregtinë rajonale, siç tregohet nga rritja 20% e tregtisë mes Shqipërisë dhe Kosovës në 2024, sipas OECD-së.

Por ky transformim nuk mund të ndodhë pa një bashkëpunim të gjerë.

Liderët duhet të punojnë me **shoqërinë civile** për të ndërtuar konsensus, siç ka ndodhur me fushatat kundër korrupsionit në Shqipëri përmes SPAK-ut, që kanë rritur besimin e investitorëve. **Qytetarët**, veçanërisht të rinjtë, duhet të angazhohen për të kërkuar llogari dhe për të mbështetur reformat. Kjo ftesë për bashkëpunim nuk është vetëm një thirrje për unitet, por një sfidë për të gjithë, nga politikanët te komunitetet lokale për të punuar së bashku për një vizion të përbashkët.

Në fund,

sfida për Shqipërinë dhe Kosovën është e qartë.

Ato duhet të shndërrohen nga vende me potencial të madh, por të brishtë, në shtete të forta dhe konkurruese.

Kjo kërkon një leadership që guxon të rrezikojë popullaritetin për të ndërtuar institucione të qëndrueshme, një ekonomi që përqafon inovacionin dhe një shoqëri që bashkohet rreth një qëllimi të përbashkët.

E gjithë kjo ka nevojë për **kurajo, bashkëpunim bazuar te një vizion i qartë strategjik i pandryshueshëm**, ku Shqipëria dhe Kosova mund ta kthejnë hartën e mundësive në një realitet të qëndrueshëm, duke sfiduar pasiguritë globale dhe duke lulëzuar në një botë në ndryshim.

Tiranë, nëntor 2025

SHQIPËRIA dhe KOSOVA PËRTEJ BRISHTËSISË

Një rrugëtim për rritje të qëndrueshme i Shqipërisë dhe Kosovës
përtej 2025